



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

C.nr.489/17

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, si gjykatë e shkallës së parë, gjyqtari Shaban Shala, me sekretaren juridike Luljeta Susuri, në kontestin e paditësit A B nga fshati K , Komuna e Prizrenit të cilin me autorizim e përfaqëson av. A R nga Prizreni, kundër të paditurës Spitali i Përgjithshëm "Prim Dr. Daut Mustafa", Prizren të cilën e përfaqëson i autorizuari S A për shkak të mos pagesës së shpërblimit jubilar dhe pagave për pension, vlera e kontestit 2.188, 80 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor në prezencën e të autorizuarve të palëve, më dt.15.11.2017 morri këtë :

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e **BAZUAR** kërkesëpadia e paditësit A B nga fshati K , Komuna e Prizrenit dhe **OBLIGOHET** e paditura Spitali i Përgjithshëm "Prim Dr. Daut Mustafa", Prizren që paditësit ti paguaj në emër të shpërblimit për tri paga jubilarë në muaj nga 364,80€ dhe për tri pagat përcjellëse për në pension po ashtu nga 364,80 €, respektivisht shumën e përgjithshme prej **2.188,80 €** (dymijë e njëqind e tetëdhjetë e tetë euro) me kamatë prej 8% duke llogaritur nga data e parashtrimit të padisë (02.04.2017) e deri në pagesën definitive në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

II. Me shpenzimet procedurale obligohet e paditura, ndërsa obligohet paditësit t'ia paguaj shpenzimet procedurale në shumën prej 394 €.

A r s y e t i m

Paditësi A B nga fshati K , Komuna e Prizrenit të cilin me autorizim e përfaqëson av. A R nga Prizreni, në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurës Spitali i Përgjithshëm "Prim Dr. Daut Mustafa", Prizren të cilën e përfaqëson i autorizuari S A për shkak të mos pagesës së shpërblimit jubilar dhe pagave për pension.

I autorizuari i paditësit av. A R gjatë shqyrtimeve gjyqësore ka deklaruar : se mbetet pranë padisë duke propozuar që pas administrimit të aprovet kërkesë padia. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga provat të cilat janë

administruar është provuar se paditësi ka punuar tek e paditura deri në pensionim. Nga Kontrata e Përgjithshme Kolektive e nënshkruar nga Qeveria e Kosovës, Oda Ekonomike dhe Bashkimit të Sindikatave rrjedh e drejta se të gjithë të pensionuarit të cilëve i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të pensionit në periudhën kohore 2015-2018 duke u bazuar në nenin 52 dhe 53 të kësaj kontrate gëzojnë të drejtën në tri paga jubilarë dhe në tri paga përcjellëse për pension dhe atë duke u bazuar në përvojën e punës, e që në rastin konkret paditësit i takojnë ngase ka përvojë pune 35 vjeçare, andaj nga këto arsye i ka propozuar gjykatës aprovimin e kërkesë padisë si dhe i ka kërkuar shpenzimet procedurale dhe atë për përpilimin e padisë 104 €, për 2 seanca të mbajtura nga 135 € dhe takson për padi në shumën prej 20 €.

I autorizuari i të paditurës gjatë shqyrtimeve gjyqësore ka deklaruar: fillimisht ka parashtruar përgjigje në padi në të cilën ka theksuar se Ligji i Punës nr.3/L-212 nuk parashih kompensimin e pagave pas pensionit, ndërsa paditësi e bazon padinë në Kontratën Kolektive e cila është lidhur për një periudhë kohore 2015-2018 ku neni 90.5 i saj përcakton se Marrëveshja Kolektive vlen për ato palë të cilat i marrin përsipër ato detyrime.

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat: ka bërë leximin e vendimit të spitalit të përgjithshëm "Prim Dr. Daut Mustafa", i dt.04.03.2015, ka bërë leximin e vendimit të MPMS Departamenti i Pensioneve i dt.07.05.2015, ka bërë shikimin në llogarinë bankare të paditësit në Pro Credit Bank të dt.29.03.2017, ka bërë leximin e kërkesës të paditësit të dt.17.01.2017 dhe ka bërë leximin e vërtetimit të paditurës për paditësin.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të theksuara më lartë në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha atë së bashku dhe ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar nga arsyerat e cekura si më poshtë.

Nga leximi i vendimit të spitalit të përgjithshëm "Prim Dr. Daut Mustafa", i dt.04.03.2015, gjykata vërteton faktin se paditësit A B i ndërpritet marrëdhënia e punës për shkak se më dt.26.02.2015 ka arritur moshën e pensionit, pra ka mbushur 65 vjet.

Nga leximi i vendimit të MPMS Departamenti i Pensioneve i dt.07.05.2015 gjykata vërteton faktin se paditësit i njihet e drejta në pension në shumën prej 140 € duke filluar nga data 09.03.2015.

Nga leximi i llogarisë bankare të paditësit në Pro Credit Bank të dt.29.03.2015 gjykata vërteton faktin se paga e paditësit të cilën e ka realizuar nga marrëdhënia e punës ka qenë 364.80 €.

Nga leximi i kërkesës së paditësit e dt.17.01.2017 gjykata vërteton faktin se paditësi i është drejtuar të paditurës që duke u bazuar në vendimin e qeverisë t'ia kompenzon tri paga.

Nga leximin i vërtetimit të paditurës nr.13/75 i dt.06.11.2017 gjykata vërteton faktin se paditësi A e B ka punuar në cilësinë e depoistit tek e paditura nga data 13.10.1980 deri më 26.02.2015.

Nga provat e administruara më lartë nuk është kontestues fakti se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura në cilësinë e depoistit mbi 30 vite, po ashtu nuk është kontestues fakti se paditësi me datën 26.02.2015 ka arritur moshën e pensionimit, pra ka mbushur moshën 65 vjet, por mbetet kontestues fakti se paditësit a i takon shpërblimi jubilar dhe për pagat përcjellëse me rastin e shkuarjes në pension për të cilën çështje gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar për shkak se kjo kërkesë e paditësit është e rregulluar me dispozita të Kontratës së Përgjithshme Kolektive e cila është nënshkruar më datën 18.03.2014 nga palët kontraktuese në këtë rast dhe nga përfaqësuesit e paditësit (Bashkimit të Sindikatave), ndërsa ka hyrë në fuqi më dt.01.01.2015 ku më nenin 52.1 pika 1.3 përcakton të drejtën e të punësuarit në tri paga jubilarë në rastin kur i punësuarit ka mbi 30 vite përvojë pune, ndërsa par. 2 i këtij neni përcakton obligimin e punëdhënësit të fundit në pagimin e këtij shpërblimi. Kurse neni 53 i saj përcakton të drejtën e të punësuarit që më rastin e shkuarjes në pension të shpërblehet në lartësinë e tri pagave që i ka marr tre muajt e fundit.

Duke u bazuar në këto dispozita materiale të cilat përcaktojnë këto të drejta dhe detyrime për palët ndërgjyqjës dhe gjendjen faktike të vërtetuar, se paditësi ka punuar mbi 30 vite tek e paditura e cila ka qenë dhe punëdhënësja e fundit i cili fakt nuk është kontestues e që vërtetohet nga vërtetimi i të paditurës dhe faktin tjetër se paditësi në tre muajt e fundit ka realizuar pagë nga e paditura në lartësi prej 364.80 € i cili fakt vërtetohet nga qarkullimi bankar i paditësit i dt.29.03.2015 gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar kërkesë padinë e paditësit me kamatë ligjore prej 8% duke llogaritur nga data e paraqitjes së padisë duke u bazuar në nenin 382 të LMD-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale bazohet në nenin 452 të LPK-së për shkak se e paditura e ka humbur kontestin dhe atë për përpilimin e padisë shumë prej 104 €, për dy përfaqësime nga 135 € dhe taksën për padi në shumë prej 20 € apo totalin prej 394 € duke u bazuar në Tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës.


Nga të dhënat e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.489/17, datë 15.11.2017

Sekretare juridike,
Luljeta Susuri



Gjyqtari
Shaban Shala



UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.